



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

SESIONI II

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Gjimnazi: Drejtimi natyror

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

3 pikë	Nëse jep tri përgjigje si më lart.
2 pikë	Nëse jep dy nga përgjigjet si më lart.
1 pikë	Nëse jep vetëm një nga përgjigjet si më lart.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

PJESA II

Shekspir

Makbethi
(fragment)

Pyetja 13	D	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	A	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	D	1 pikë
Pyetja 18	A	1 pikë

Pyetja 19 **3 pikë**

Model përgjigjeje

Tri pikat kryesore të subjektit dramatik janë:

- a- Makbethi dhe znj Makbeth ftojnë në festë Bankon.
- b- Makbethi shpjegon pse ka frikë nga Banko.
- c- Vendimi që duhet ta vrasë atë patjetër dhe në mënyrë të shpejtë.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

3 pikë	Nëse jep tri përgjigje si më lart.
2 pikë	Nëse jep dy nga përgjigjet si më lart.
1 pikë	Nëse jep një nga përgjigjet si më lart.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **2 pikë**

Model përgjigjeje

- a- kuptimi është i lidhur me mendimin e Makbethit se trashëgimtarë do të jenë fëmijët e Bankos. Për të mos ndodhur kjo ai duhet të veprojë shpejt dhe pasoja e veprimit të tij duhet të jetë vdekja, që fronti të jetë vetëm i Makbethit, etj.
- b- fjalët janë **jetë** dhe **vdekje**.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

2 pikë	Nëse jep dy përgjigje si më lart.
1 pikë	Nëse jep një nga përgjigjet si më lart.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 3 pikë**Model përgjigjeje****a dhe b:****Makbethi më monologun e tij karakterizohet nga:**

- frika.
- inferioriteti ndaj Bankos.
- dilema mbi gjeninë e tij.
- vendosmëria për të vrarë.
- vendosmëria për të vrarë shpejt.
- etj.

c- Pashirra

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 3 pikë** Nëse jep tri përgjigje të ngjashme me modelin a) b) c).
2 pikë Nëse jep vetëm dy nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
1 pikë Nëse jep vetëm një nga përgjigjet sipas modelit a) b) c).
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë**Model përgjigjeje****a- Makbethi del në fragment:**

- i frikësuar.
- inferior ndaj Bankos.
- ka dyshime mbi gjeninë e tij.
- i vendosur për të vrarë.
- i vendosur për të vrarë shpejt .
- etj.

b- Banko del në fragment:

- besnik,
- trim,
- i bindur,
- besues,
- i ndershëm,
- i sjellshëm,
- mirënjohës,
- etj.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.

- 2 pikë** Nëse jep një tipar për secilin dhe që i dallon ata.
1 pikë Nëse jep vetëm një tipar që i përshtatet njërit prej personazheve.
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **3 pikë****Model përgjigjeje**a- *natyra mbretërore*

b- emër dhe mbiemër

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.**3 pikë** Nëse identifikon togfjalëshin dhe jep formimin e tij.**2 pikë** Nëse tregon vetëm togfjalëshin dhe një element formues të tij, ose nëse jep vetëm formimin e plotë të togfjalëshit.**1 pikë** Nëse tregon vetëm togfjalëshin.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 24** **2 pikë****Model përgjigjeje**

a- një mënyrë shumë të afërt të tij me vrasësit.

b- kjo tregon se ai me kohë e kishte kopsitur planin e vrasjes.

shënim: çdo përgjigje e nxënësit që i afrohet modelit të përgjigjes, do të merret si pozitive.**2 pikë** Nëse jep dy përgjigje si më lart.**1 pikë** Nëse përgjigjet vetëm për njërin nga ato.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 25** **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton dëmin që sjellin pasionet e paarsyeshme te njeriu.
- shpjegon pse ndodh kjo dhe si ndodh kjo.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:

hyrjen
zhvillimin
përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë Organizimi i esesë

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 2 pikë

(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.